



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/  
REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME  
ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PREDSEDNIKA/MAYOR'S OFFICE

Nr. i Protokollit: 02/ 681  
24/06/2025

**Procesverbal nga dëgjimi publik me banorët e fshatit Rashincë**

E hëne, më 16 qershor 2025

Kohëzgjatja e takimit: 19:45 – 21:20

Vendi i takimit: SHF "Lasgush Poradeci"

Pjesëmarrës në takim ishin: Kryetari i Komunës z. Qemajl Aliu, Drejtori i Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi - Grejtalb Emini dhe Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike – Bardhyl Rushiti, Asamblesitët- Besnik Seferi dhe Sanie Sadiku.

Rendi i ditës:

**1. Korniza Afatmesme Buxhetore 2026-2028**

**Kryetari i Komunës z. Qemajl Aliu:** Ju përshëndes të gjithëve dhe faleminderit që keni ndar kohë të ju përgjigjeni ftesës sonë për dëgjim publik. Sot jam së bashku me bashkëpunotë siç po e shiheni, me Drejtorin e Urbanizmit, Grejtalb Emini, Drejtorin e Shërbimeve Publike, Bardhyl Rushitin, Gentiana Mehmetin e cila është pjesë e kabinetit tonë si dhe më asambleistët Besnik Seferi dhe Sanie Sadiku. Faleminderit po ashtu edhe Gëzim Haxhiut i cili është pjesë e asambleistëve tanë dhe djali i juaji.

Siç e dini ky është viti i katërt që ne i mbajm dëgjimet publike, para së të bëhet hartimi i buxhetit në dalim në dëgjime publike në secilin vendbanim.

Buxheti i ka dy komponent kryesisht, komponenti i parë janë kërkesat të cilat vijnë direkt nga qytetarët dhe komponenti tjetër është zotimet tona, premtimet të cilat i kemi dhënë para se të vijm në detyrë, të cilën ju na keni besuar dhe na i keni dhënë. Kështu që këto dy komponenta e përbëjnë buxhetin edhe vizionin se qysh ne ecim çdo vit.

Kësaj radhe ne jemi këtu për buxhetin e vitit 2026, kërkesat mirren tani, votohen në shtator edhe projektohen gjatë vjeshtës dhe në fillim të pranverës fillon implementimi i tyre.

Kësaj radhe ka dashur fati i komunës tonë që përveç buxhetit komunal ne të kemi edhe ndihmën e qeverisë. Ju jemi falënderues edhe ministrave si dhe Kryeministrit që asnjëherë nuk na kanë kthyer duarthatë kur kemi kërkuar nga ta investime.

Ju po e shihni që janë bukur shumë projekte të cilat janë duke u implementuar në të gjithë territorin e Komunës së Shtimes, në këtë rast edhe në fshatin Rashincë.

Një llogaritje të cilën e kemi bërë me bashkëpunotë, në Komunën e Shtimes përveç buxhetit komunal, janë 55 milion euro plus nga mbështetja qeveritare të cilën e kemi për zhvillimin e komunës tonë, për ata të cilën ne e kemi quajtur fizionomi urbane.

Këtu jemi që t'i dëgjojmë kërkesat e juaja nevojat e juaja më prioritare, po shpresoj që secila lagje sot këtu ka përfaqësuesit e vetë dhe jeni të lirë t'i bëni kërkesat e juaja.

Kërkesat e banorëve të fshatit :

- **Bekim Canolli:** Nga Xhamia deri tek shkolla duhet të bëhet një parking, oborri te Xhamia ka hapsirë, nëse ka mundësi të bëhet një parking të paktën të rregullohet me zall. Trotuari nga shkolla të vazhdoj deri ne fshatin Muzeqinë.
- **Milaim Rushiti:** Trotuari dhe parkingu të rregullohet për tek Observatori pasi që është i nevojshëm për vizitorët. Shenjëzimi i rrugës për të treguar rrugën drejtë Observatorit.
- **Enver Rexha:** Rruga "Rexha" të asfaltohet 200m.

Procesmbajtës,  
Gentiana Mehmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA-SHTIME/OPŠTINA-ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Lista e pjesëmarrësve në dëgjimin publik në: Roshinco

Date: 16.06.2025

| Nr | Emri dhe Mbiemri  | Nenshkrimi |
|----|-------------------|------------|
| 1  | SABIT RUSHITI     |            |
| 2  | HINZI RUSHITI     |            |
| 3  | Abdurelam Rushiti |            |
| 4  | NAZIF RUSHITI     |            |
| 5  | Behmet Corrolli   |            |
| 6  | Muhamet Corrolli  |            |
| 7  | GËZIM HAXHIU      |            |
| 8  | ISLAM RUSHITI     |            |
| 9  | BEKIM CANKLI      |            |
| 10 | Kushtrim Haxhiu   |            |
| 11 | Muharrem Rushiti  |            |
| 12 | Hrushiti          |            |
| 13 | Agdon Daxelli     |            |
| 14 | Erves Fashaj      |            |
| 15 | HAGIT DASHILI     |            |
| 16 | EDON RUSHITI      |            |
| 17 | Zon Haxhiu        |            |

|    |                |     |
|----|----------------|-----|
| 18 | MILAIM RUSHITI | My. |
| 19 |                |     |
| 20 |                |     |
| 21 |                |     |
| 22 |                |     |
| 23 |                |     |
| 24 |                |     |
| 25 |                |     |
| 26 |                |     |
| 27 |                |     |
| 28 |                |     |
| 29 |                |     |
| 30 |                |     |
| 31 |                |     |
| 32 |                |     |
| 33 |                |     |
| 34 |                |     |
| 35 |                |     |
| 36 |                |     |
| 37 |                |     |
| 38 |                |     |
| 39 |                |     |
| 40 |                |     |
| 41 |                |     |